



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 126-22/2018 regjistër (JR)  
Datë 02.11.2023

Nr. 45 i vendimit  
Datë 10.03.2026

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Sokol Çomo</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 10.03.2026, ditën e martë, ora 10.20, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 126-22/2018 (JR), datë 02.11.2023, që i përket:

**KËRKUES:** Admir Thanza, me adresë rruga “{\*\*\*}”, Nd. {\*\*\*}, H. {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}, Selitë, Farkë, Tiranë, me adresë elektronike, email: {\*\*\*}.

**OBJEKTI:** Rishikimin e vendimit nr. 10, datë 18.04.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 40, datë 17.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Admir Thanza”.

**BAZA LIGJORE:** Preambula e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenet 3, 17/2, 116 dhe 122 të Kushtetutës; nenet 6, 19 dhe 46 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Vendimi “Thanza v. Albania” (Aplikimi nr. 41047/19), datë 4 korrik 2023, final 4 tetor 2023, i GjEDNj-së; neni 71/c i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”; nenet 494 e vijuese të Kodit të Procedurës Civile.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, shqyrtoi pretendimet e kërkuarit në kërkesën e paraqitur prej tij dhe parashtrimet me shkrim, i cili përfundimisht kërkoi rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 10/2019 (JR), datë 18.04.2019, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Z. Admir Thanza (në vijim “kërkuari”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 40, datë 17.07.2018, ka vendosur: *shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Admir Thanza, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë*. Këtë vendim, kërkuari e ankimoi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), i cili mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, shkaqet e ankimit të pretenduara nga z. Thanza dhe, me vendimin nr. 10, datë 18.04.2019, vendosi: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 40, datë 17.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Admir Thanza”*.
2. Kërkuari i është drejtuar me ankim Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”), duke pretenduar shkelje të neneve 6, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), gjatë procedurës së rivlerësimit nga organet e rivlerësimit në Shqipëri. GjEDNj-ja me vendimin nr. aplikimi 41047/19, datë 4 korrik 2023, ka vendosur:
  1. *I deklaron, në mënyrë unanime, ankesat e bëra në mbështetje të nenit 6 (në pjesën në lidhje me të drejtën për një gjykim të drejtë) dhe nenit 8 (në lidhje me shkarkimin nga detyra) të Konventës të pranueshme;*
  2. *I deklaron, me shumicë, ankesat e tjera bërë në mbështetje të neneve 6 dhe 8 të Konventës të papranueshme;*
  3. *Gjykon, në mënyrë unanime, se është shkelur neni 6 i Konventës;*
  4. *Gjykon, me gjashtë vota pro dhe një kundër, se nuk është shkelur neni 8 i Konventës;*
  5. *Gjykon, me gjashtë vota pro dhe një kundër, se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankesa e bërë në mbështetje të nenit 13 të Konventës;*
  6. *Gjykon, me gjashtë vota pro dhe një kundër, se konstatimi i shkeljes përbën në vetvete mjaftueshëm gjykim të drejtë për dëmin jopasuror që ka pësuar kërkuari;*
  7. *Gjykon, në mënyrë unanime: a) se Shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuarit, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi bëhet i formës së prerë, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, 3.500 euro (tre mijë e pesëqind euro) plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuarit, për kostot dhe shpenzimet, të konvertuara në monedhën e Shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;*

8. *Rrëzon, me gjashtë vota pro dhe një kundër, pjesën e mbetur të pretendimit të kërkuarit për gjykim të drejtë.*

3. Në datën 02.11.2023, z. Admir Thanza depozitoi në Kolegj kërkesën me objekt: *“Rishikimin e vendimit nr. 10, datë 18.04.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”.*

## **II. Pretendimet e kërkuarit**

4. Kërkuari Admir Thanza, në kërkesën për rishikim vendimi, drejtuar Kolegjit, ka paraqitur si argumente kryesore konstatimet dhe konkluzionet e vendimit të sipërcituar të GjEDNj-së në çështjen *“Thanza kundër Shqipërisë”*, për shkak se kjo Gjykatë ka konstatuar shkelje të nenit 6 të Konventës nga organet e rivlerësimit në Shqipëri, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, konkretisht:

4.1. Kërkuari, duke iu referuar nenit 497 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe nenit 71/c të ligjit nr. 8577, datë 10.0.2000, *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”*, të ndryshuar, parashtron se, duke qenë se Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka qenë instanca e parë dhe e vetme gjyqësore që ka shqyrtuar ankimin e tij, atëherë kompetenca për të shqyrtuar këtë kërkesë për rishikim i takon Kolegjit. Referuar dispozitave të mësipërme, kërkuari çmon se cenimi i konstatuar nga GjEDNj-ja përbën shkak ligjor për rishikimin e vendimit të Kolegjit për rihapjen e procedurave (*ratione materiae*) dhe ka interes të ligjshëm për të paraqitur kërkesën për rishikim, sepse GjEDNj-ja ka konstatuar se qasja e organeve të *vetting*-ut në lidhje me komponentin e dytë të vlerësimit, ndaj subjektit Admir Thanza, nuk ka qenë në përputhje me kriterin e drejtësisë të nenit 6 të Konventës.

4.2. Kërkuari parashtron se në rastet kur GjEDNj-ja konstaton se një shtet palë ka shkelur Konventën ose Protokollin e saj, referuar nenit 46 të Konventës, shteti ka detyrimin që të veprojë në përputhje me vendimin e kësaj gjykate dhe duhet të marrë masa individuale për rastin e konstatuar, që t’i japë fund shkeljes së gjetur nga GjEDNj-ja, me qëllim që kërkuari të rikthehet, për aq sa është e mundur, në gjendjen që ishte përpara se të bëhej shkelja.

4.3. Sipas kërkuarit, referuar përcaktimeve në Kushtetutë, por edhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi rëndësinë dhe vlerat unike që mbart dinjiteti i njeriut, nga të cilat burojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të tij, ai kërkon rivendosjen e së drejtës së shkelur, të konstatuar nga vendimi i GjEDNj-së, pasi vendimmarrja e organeve të rivlerësimit ka cenuar rëndë dinjitetin dhe personalitetin e tij.

4.4. Në përfundim, kërkuari kërkon nga Kolegji pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit nr. 10, datë 18.04.2019, prishjen pjesërisht të këtij vendimi, që ka vendosur *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 40, datë 17.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Admir Thanza”*, dhe gjykimin e çështjes në themel, duke konfirmuar se subjekti i rivlerësimit Admir Thanza ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të pikës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

## **III. Lidhur me shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 10/2019 (JR), datë 18.04.2019**

5. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi, kërkesën e sipërcituar, vlerësoi si vijon sa i takon:

## A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

### a) Juridiksioni i Kolegjit

5.1. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, në zbatim të leximit harmonik e integral të dispozitave të nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Kolegji zbaton edhe dispozitat procedurale administrative e ato civile, kur është rasti. Gjithashtu, duke mbajtur në konsideratë qëndrimin tashmë të konsoliduar të Kolegjit në vendimmarrjet<sup>1</sup> e tij për kërkesat me objekt rishikimin e vendimeve, Kolegji ka juridiksion rishikues vetëm mbi bazë të një vendimi të posaçëm të GjEDNj-së ndaj kërkesit, sipas nenit 494, shkronja “ë” të Kodit të Procedurës Civile, që potencialisht konstaton se ekzistojnë shkaqet që përlligjin shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë të tij.

Për rrjedhojë, shqyrtimi i kësaj kërkesë, për sa kohë ka për objekt rishikimin e një vendimi të Kolegjit, i cili ka vendosur përfundimisht mbi procesin e rivlerësimit për ish-subjektin, z. Admir Thanza, mbi bazën e ankimit të ushtruar prej tij në Kolegji, vendim i cili ka marrë formë të prerë, bazuar në parashikimin e nenit 497, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile<sup>2</sup>, bën pjesë në kompetencën lëndore të Kolegjit, si gjykata më e lartë, që ka shqyrtuar në themel çështjen për të cilën është marrë vendimi që kërkohet të rishikohet.

### b) Legjitimimi i ankuesit

5.2. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 496 i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala provon se ka marrë djeni për shkakun e rishikimit. Sikurse rezulton nga aktet bashkëlidhur kërkesës për rishikim, vendimi për të cilin kërkuesi pretendon se janë vërtetuar rrethanat për rishikim, është vendimi nr. aplikimi 41047/19, datë 4 korrik 2023, i GjEDNj-së, “Thanza kundër Shqipërisë”. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 04.10.2023 dhe është publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 162, datë 09.11.2023. Kërkesa për rishikim e kërkuesit Admir Thanza është protokolluar në Kolegji me nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2023. Sikurse vërehet, kërkuesi e ka paraqitur kërkesën për rishikim brenda afatit 30-ditor të parashikuar nga ligji, në përputhje me nenin 496 të Kodit të Procedurës Civile.

<sup>1</sup> Vendim nr. 12, datë 19.04.2024, i Kolegjit, nr. {\*\*\*}/2019 regjistër, datë 10.01.2022, që i përket kërkuesit Artor Ylli, paragrafët 13, 14 dhe 17.

<sup>2</sup> Neni 497, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile përcakton: “Kërkesa për rishikim paraqitet para Gjykatës së Shkallës së Parë që ka dhënë vendimin, por në rast se vendimi është ankimuar në gjykatat më të larta, kompetente është gjykata më e lartë që ka shqyrtuar çështjen në themel. Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rishikim gjykon sipas rregullave të zbatueshme për atë shkallë gjykimi. Kërkesa duhet të përmbajë: shkakun për të cilin kërkohet rishikimi, provat përkatëse që lidhen me një nga kërkesat e nenit 494 të këtij Kodi, ditën e zbulimit ose të vërtetimit të rrethanës, ose marrjes së dokumenteve”.

5.3. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, lexuar ky në harmoni me nenin F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, me nenin 4, pika 6, dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile<sup>3</sup>.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

5.4. Në përputhje me nenin 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese<sup>4</sup>, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se nga verifikimi i legjitimitetit të kërkuesit, bazueshmëria në ligj dhe në prova e kërkesës për rishikimin e vendimit, si dhe prania e kriterëve ligjore për shqyrtimin e saj, kjo çështje mund të gjykohet në dhomë këshillimi, me qëllim analizimin dhe më pas konstatimin nëse ekzistojnë shkaqet e parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, të pretenduara nga kërkuesi në kërkesën e tij për rishikim.

**B. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

6. Trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”) vëren se në kushtet kur kërkuesi, në kërkesën e paraqitur për rishikimin e vendimit të Kolegjit nr.10, datë 18.04.2019, ka paraqitur si argument konstatimet dhe konkluzionet e vendimit nr. 41047/19, datë 4 korrik 2023, të GjEDNj-së, në çështjen “Thanza kundër Shqipërisë”, mori në analizë konkluzionet e këtij vendimi, duke i analizuar ato në raport me kërkesat e kërkuesit, kuadrin ligjor të zbatueshëm dhe jurisprudencën e vetë GjEDNj-së.
7. Trupi gjykues, nga analizimi i vendimit dhe i konkluzioneve të paraqitura në vendimin e GjEDNj-së, konstaton se, krahas pranimit të kërkesës për shkelje të nenit 6 të Konventës, kjo Gjykatë ka refuzuar kërkesën e z. Thanza për rikthim në detyrë apo masa të tjera individuale, sa kohë që, në vlerësim të nenit 8 të Konventës, ka konkluduar se nuk ka pasur mangësi në lidhje me procesin e vlerësimit të pasurive të z. Thanza, komponent i cili përbënte një bazë ligjore të veçantë dhe të mjaftueshme për shkarkimin e tij nga organet e rivlerësimit. Duke pasur parasysh juridiksionin e saj, si dhe natyrën dhe shtrirjen e shkeljes së konstatuar, kjo Gjykatë nuk e ka parë të përshtatshme të indikojë në rastin konkret asnjë masë individuale dhe të përgjithshme.

7.1. Konkretisht, në paragrafin 170 të vendimit, Gjykata shprehet se: *nuk ka konstatuar shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me gjetjet e organeve të verifikimit mbi vlerësimin e pasurisë. Ajo, gjithashtu, ka shqyrtuar, për herë të parë, një ankesë sipas nenit 6 të Konventës në lidhje me vlerësimin e figurës dhe ka konstatuar një shkelje të kësaj dispozite, për shkak të disa mangësive që dalin nga faktet specifike të çështjes në fjalë<sup>5</sup>. Duke pasur parasysh juridiksionin e saj dhe natyrën dhe shtrirjen e shkeljes së konstatuar, Gjykata refuzon kërkesën e kërkuesit, që Gjykata t'i kërkojë Qeverisë ta riemërojë atë në detyrë [...]. Gjykata nuk e sheh të përshtatshme të përcaktojë*

---

<sup>3</sup> Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr. 2/2008, në interpretim të “palës së interesuar”, referuar përcaktimit në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, ka arsyetuar: “Sipas nenit 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, e drejta për të paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë për rishikimin e një vendimi të formës së prerë, i përket në mënyrë të pavarur çdo personi që ka qenë palë në gjykimin e çështjes, për të cilën është dhënë vendimi dhe që ka interes të ligjshëm për rishikimin e tij”.

<sup>4</sup> Shih vendimet nr. 8/2002, nr. 6/2003, nr. 17/2005, nr. 8/2006, nr. 5/2007 dhe nr. 4/2009, të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>5</sup> Në paragrafin 123 të vendimit, GjEDNj-ja ka konstatuar se: [...] Duke marrë parasysh gjetjet e sipërpërmendura në mënyrë kumulative, Gjykata arrin në përfundimin se qasja e organeve të vetting-ut për vlerësimin e komponentit të dytë të procesit të vetting-ut, që rezultoi në gjetje të gjera, që konsideroheshin të mjaftueshme për shkarkimin nga detyra, nuk ishte në përputhje me parashikimin për drejtësi në nenin 6 § 1 të Konventës, në rastin konkret. Prandaj ka pasur shkelje të këtij neni në lidhje me komponentin e dytë të procesit të vetting-ut [...].

*përrjashtimisht ndonjë masë të përgjithshme, që mund të merret për t'i dhënë fund shkeljes në fjalë [...].*

8. GjEDNj-ja, pavarësisht shkeljes procedurale të konstatuar në vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës, ka konsideruar në përputhje me garancitë e neneve 6 dhe 8 të Konventës, se procedurat e vetting-ut lidhur me komponentin e vlerësimit të pasurisë në vetvete, kanë përbërë një bazë të mjaftueshme ligjore për shkarkimin e kërkuarit nga detyra<sup>6</sup>. GjEDNj-ja<sup>7</sup> ka arritur në përfundimin se: *shkarkimi i kërkuarit nga detyra ishte në përputhje me kërkesat e nenit 8 të Konventës... Së fundi, për sa i përket pasojave të caktuara në lidhje me gjetjet e bëra nga organet e verifikimit dhe shkarkimin e ankuesit nga detyra, Gjykata i referohet gjetjeve të saj në “Xhoxhaj” (cituar më lart, § 413) dhe vëren se kërkuari nuk ka treguar se shkarkimi i tij nga detyra kishte pasoja të tjera negative, si, për shembull, refuzimi i punësimit në një post të caktuar në shërbimin civil ose ndalimi për të kryer veprimtari specifike si ekspert. Rezulton se ai mund të ushtronte profesionin e avokatit (shih paragrafin 134 më lart)... Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës, për shkak të shkarkimit të kërkuarit nga detyra.*

8.1. Sa i përket pretendimit për ndalimin e ushtrimit të profesionit të avokatit, GjEDNj-ja e vlerësoi ankesën si të papranueshme, duke konkluduar se nuk kishte pasur shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare.

8.2. Në lidhje me shkeljen e pretenduar të nenit 13 të Konventës, në referencë të gjetjeve të saj, për sa i përket nenit 6 të Konventës, GjEDNj-ja nuk e konsideroi të nevojshme të ekzaminojë pretendimet për shkelje të nenit 13 të Konventës.

8.3. Në lidhje me shpërblimin e drejtë, kërkuari pretendoi 216.239 euro, lidhur me dëmin pasuror dhe jopasuror. Gjykata vendosi të hedhë poshtë të gjitha pretendimet e kërkuarit për shpërblim të drejtë dhe i akordoi atij vetëm 3.500 euro për kostot dhe shpenzimet.

9. Lidhur me pretendimin e subjektit, *se vendimmarrja e organeve të rivlerësimit ka cenuar rëndë dinjitetin dhe personalitetin e tij, duke kërkuar që, nëpërmjet rishikimit të vendimit nr. 10, datë 18.04.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, dhe gjykimin e çështjes në themel, të konfirmohet se subjekti i rivlerësimit Admir Thanza ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të pikës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, referuar vendimit konkret të GjEDNj-së, në çështjen “Thanza kundër Shqipërisë”, vëren se shkelja procedurale e konstatuar nuk cenon thelbin e vlerësimit për kriterin e figurës, si dhe nuk vë në dyshim rezultatin përfundimtar të procesit të rivlerësimit të subjektit.*

---

<sup>6</sup> Në paragrafin 158 të vendimit të GjEDNj-së citohet se: *“Pasi shqyrtoi pretendimet e ankuesit, Gjykata nuk ka identifikuar asnjë mangësi serioze në procesin e vendimmarrjes, me të cilën janë arritur gjetjet faktike të lartpërmendura në nivel kombëtar (shih gjithashtu paragrafin 108, më lart). Këto gjetje dhe interpretimi i ligjit kombëtar nuk duket se kanë qenë arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Organet e vetting-ut vlerësuan se gjetjet në lidhje me vlerësimin e pasurisë justifikonin shkarkimin e kërkuarit nga detyra. Pasi shqyrtoi materialin në dispozicion, Gjykata nuk ka arsye të distancohet nga këto përfundime. Ajo vlerëson se arsyet e paraqitura nga organet e vetting-ut për të justifikuar shkarkimin e tij nga detyra nën këtë kategori ishin relevante dhe të mjaftueshme, dhe se në rrethanat e çështjes ky vendim ishte proporcional me qëllimet legjitime sipas nenit 8 të Konventës (shih paragrafin 147, më lart).*

*Ndërsa në paragrafin 159 citohet se: “Në këtë mënyrë, pavarësisht nga mangësitë procedurale të identifikuar sipas nenit 6 të Konventës, në lidhje me vlerësimin e figurës (shih paragrafin 123, më lart), Gjykata vlerëson se shkarkimi i kërkuarit nga detyra ishte i justifikuar si i nevojshëm në një shoqëri demokratike, sipas nenit 8 të Konventës, për shkak të pasurive të pafavorshme dhe vlerësimit të integritetit financiar”.*

<sup>7</sup> Paragrafët 161, 162 dhe 163 të vendimit të GjEDNj-së.

9.1. Rishikimi në këtë kontekst duhet të shërbejë për të eliminuar pasojat konkrete të shkeljes së konstatuar, për të rivendosur (nëse është e nevojshme), garancinë procedurale të cenuar, por nuk mund të shërbejë si qëllim i vetëm për riformulim të vlerësimeve të themelit mbi kontrollin e kriterit të figurës, kur shkelja nuk ka ndikuar në përfundimin e arritur për figurën. Integriteti i figurës, në kontekstin e procesit të rivlerësimit, është objekt vlerësimi administrativ kushtetues dhe komponenti i figurës vlerësohet në funksion të besimit të publikut, duke pasqyruar një vlerësim institucional që nuk ka qëllim për të dhënë “etiketa morale”, rehabilituese ose ndëshkuese, apo të bëjë gjykim etik për dinjitetin personal. Për pasojë, ndryshimi i arsytimit, vetëm për arsye reputacionale, do ta kthente Kolegjin, nga Gjykata e vetme e procesit të rivlerësimit, në organ rehabilitimi moral, rol që Kushtetuta dhe ligji nuk ia japin.

10. Trupi gjykues vëren se, në vendimin e saj, GjEDNJ-ja ka konstatuar një shkelje të natyrës procedurale, pa arritur në përfundimin se kjo shkelje ka ndikuar në thelbin e drejtësisë materiale të procesit. Në mënyrë të veçantë, GjEDNJ-ja nuk ka konstatuar se, në mungesë të kësaj shkeljeje procedurale, rezultati i procesit të rivlerësimit do të kishte qenë ndryshe, çka nënkupton se cenimi i konstatuar nuk ka pasur ndikim vendimtar në rezultatin përfundimtar të çështjes. Në këtë kontekst, trupi gjykues çmon se dallimi midis drejtësisë procedurale dhe asaj materiale është thelbësor për vlerësimin e pasojave juridike të shkeljes së konstatuar. Ndërsa respektimi i garancive procedurale përbën një element të rëndësishëm të një procesi të rregullt ligjor, jo çdo devijim nga këto standarde çon automatikisht në pavlefshmëri të rezultatit përfundimtar, për aq kohë sa nuk provohet një lidhje shkakësore midis shkeljes së konstatuar dhe përfundimit të arritur.

10.1. Parë në këtë këndvështrim, trupi gjykues e konsideron të nevojshme, në formën e një *obiter dictum*, të theksojë se, edhe në rastin hipotetik të pranimit të kërkesës së kërkuarit dhe konstatimit të pasojave juridike të shkeljes procedurale, analiza e fakteve dhe e provave të administruara në dosje nuk do të çonte në një përfundim të ndryshëm lidhur me përgjegjësinë disiplinore të tij. Elementet faktike dhe juridike që kanë mbështetur vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra mbeten të pandryshuara dhe të mjaftueshme për të justifikuar këtë masë. Për më tepër, trupi gjykues vlerëson se parimi i proporcionalitetit dhe ai i efektivitetit të drejtësisë kërkojnë që ndërhyrja në vendimmarrje të justifikohet vetëm kur shkelja procedurale ka ndikuar realisht në të drejtat substanciale të palës ose në rezultatin e procesit. Në mungesë të një ndikimi të tillë, rivendosja e çështjes në një fazë të mëpasshme apo ndryshimi i rezultatit do të përbënte një formalizëm të tepër, në kundërshtim me qëllimin e drejtësisë efektive.

11. Trupi gjykues, referuar jurisprudencës<sup>8</sup> së GjEDNJ-së, çmon se jo çdo shkelje procedurale prodhon pasojë materiale, veçanërisht kur subjekti ka pasur mundësi reale për t'u dëgjuar në tërësi, në kushtet kur shkelja nuk ka qenë determinante për konkluzionin përfundimtar, si dhe nuk ekziston lidhje shkakësore mes shkeljes së konstatuar dhe përfundimit për kriterin e kontrollit për figurën. Në rastin e z. Thanza, GjEDNJ-ja konstatoi shkelje procedurale, por nuk konkludoi se pa këtë shkelje rezultati do të kishte qenë i ndryshëm dhe nuk vuri në dyshim përfundimin për kriterin e kontrollit të figurës. Aq më tepër që shkelja e konstatuar lidhet me arsyet ligjore për refuzimin e aksesit në informacion ndaj subjektit, të disa të dhënave të një organi ndihmës, sikurse është Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK). Në përputhje me interpretimin pajtues të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, raportet që hartohen nga institucionet e drejtësisë, si organe ndihmëse në funksion të procesit të rivlerësimit, nuk kushtëzojnë vendimmarrjen e organeve të rivlerësimit brenda fushës së tyre të veprimit, pra përmbajtja e të dhënave në këto dokumente është e natyrës ndihmëse

<sup>8</sup> *Moreira Ferreira v. Portugal* – <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-175646>

për procesin e rivlerësimit të subjekteve dhe jo përcaktuese për thelbin e vendimmarrjes. Institucionet e rivlerësimit, sipas neneve 45 e 50 të ligjit nr. 84/2016, kanë detyrimin të kryejnë hetim të pavarur për të gjitha rrethanat e çështjes, në funksion të përmbushjes së qëllimit të shpallur në nenin 179/b të Kushtetutës, për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Trupi gjykues çmon se shkelja procedurale e konstatuar nuk cenon vlefshmërinë materiale të vendimmarrjes dhe nuk krijon bazë për një zgjidhje të ndryshme të çështjes, duke lënë të paprekur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

12. Trupi gjykues çmon se, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, e drejta për një proces të rregullt ligjor garantohet si standard procedural dhe jo si e drejtë për rihapje të pakushtëzuar të procedurave të përfunduara, veçanërisht kur shkelja e konstatuar ka natyrë formale dhe nuk ka ndikuar në drejtësinë materiale të procesit të rivlerësimit. Po ashtu, në referim të nenit 145 të Kushtetutës, i cili sanksionon detyrimin e gjyqtarëve për t'iu nënshtruar Kushtetutës dhe ligjit, si dhe parimin e pavarësisë në ushtrimin e funksionit gjyqësor, vendimmarrja e organeve të rivlerësimit, e bazuar në kritere kushtetuese dhe ligjore të posaçme, nuk mund të vihet në dyshim sa i përket themelit të çështjes apo kur vetë GjEDNj-ja nuk e ka autorizuar një gjë tilla.

12.1. Për sa kohë shkelja procedurale e konstatuar nga GjEDNj-ja nuk ka prekur themelin e çështjes dhe nuk është shoqëruar me urdhërim për masa individuale, trupi gjykues çmon të theksojë se ajo nuk mund të krijojë detyrim kushtetues apo ligjor për rishikimin e vendimit përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar. Edhe vetë kërkuesi, në kërkesën për rishikim, kërkon vetëm ndryshimin e pjesshëm të vendimit të Kolegjit, duke mos arritur të cenojë thelbin e vendimmarrjes në vendimin e themelit dhe, për rrjedhojë, duke konfirmuar qëndrimin e mbajtur nga ky trup gjykues në arsyetimin e këtij vendimi. Bazuar në këto argumente, Kolegji nuk ka kompetencë që të shpallë një rezultat të ri për kriterin e figurës, kur vetë GjEDNj-ja nuk e ka kërkuar dhe as sugjeruar një veprim të tillë.

13. Lidhur me pretendimin e kërkuarit për rivendosjen e dinjitetit njerëzor, nëpërmjet rishikimit të vendimit, trupi gjykues sjell në vëmendje se, në paragrafin 174 të vendimit të saj, GjEDNj-ja shprehet se: “Gjykata vlerëson gjithashtu se konstatimi i shkeljes së nenit 6§1 të Konventës përbën në vetvete një kompensim të drejtë të mjaftueshëm për sa i përket dëmit jopasuror në çështjen në fjalë”. Pra, është kjo Gjykatë që ka vlerësuar se vetë konstatimi i shkeljes së nenit 6§1 të Konventës ka përbërë në vetvete një kompensim të drejtë e të mjaftueshëm për sa i përket dëmit jopasuror në çështjen në fjalë. Sipas jurisprudencës<sup>9</sup> së GjEDNJ-së, në rastet kur Gjykata deklaron se: “vetë konstatimi është kompensim i mjaftueshëm”, detyrimi i shtetit për masa individuale nuk lind automatikisht. Vetë GjEDNJ-ja bën dallim të qartë mes: shkeljeve (a) që kërkojnë *restitutio in integrum* (për shembull, proces i padrejtë që ka ndikuar në rezultatin), dhe (b) shkeljeve që riparohen me konstatim plus dëmshpërblim, pa rihapje. Konstatimi i shkeljes procedurale dhe kur ka dëmshpërblim për dëmin jopasuror, konsiderohet riparim i mjaftueshëm moral. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se, në jurisprudencën e saj, GjEDNJ-ja<sup>10</sup> ka vlerësuar që rihapja e procedurave nuk përbën një mjet të

---

<sup>9</sup> “Eckle v. Germany”, në paragrafin 6, Gjykata shprehet: “Gjykata konsideron se konstatimi i një shkeljeje përbën në vetvete një shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për çdo dëm jomaterial të pësuar nga aplikanti”. – <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-57476>

Po ashtu dhe në vendimet: “Hirst v. The United Kingdom”; “Norris v Ireland” dhe “Dudgeon v The United Kingdom”.

<sup>10</sup> Në çështjen “Bochan kundër Ukrainës” (nr. 2) GC, 2015, GjEDNJ-ja ka sqaruar se rihapja e procedurave nuk përbën një mjet të domosdoshëm riparimi për çdo shkelje të nenit 6 dhe se, në shumë raste, vetë konstatimi i shkeljes përbën një formë të mjaftueshme korrigjimi. – <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-152331>

Në çështjen “Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë” (GC, 2018), Gjykata konstatoi shkelje të standardeve procedurale të nenit 6, pa nxjerrë përfundime negative mbi integritetin profesional të gjyqtarës dhe pa urdhëruar masa

domosdoshëm riparimi për çdo shkelje të nenit 6 të Konventës dhe se, në shumë raste, konstatimi i shkeljes ka përbërë një formë të mjaftueshme korigjimi, pa kërkuar domosdoshmërisht ndërhyrje të mëtejshme në rendin juridik të brendshëm, përtej deklaratimit të saj. Gjithashtu, botimi i vendimit të GjEDNj-së në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë i jep atij një autoritet juridik në kuadër të legjislacionit të brendshëm,<sup>11</sup> duke i dhënë në këtë mënyrë fuqi zyrtare dhe ekzekutive, duke e bërë të njohur dhe të detyrueshëm për institucionet vendase, si dhe duke siguruar transparencë dhe siguri juridike. Trupi gjykues vlerëson se, në rrethanat e çështjes, vetë konstatimi i shkeljes nga GjEDNj-ja, përmbush funksionin e një mjeti efektiv riparimi në aspektin moral dhe juridik, pa e bërë të nevojshëm rishikimin e vendimit, si një mjet shtesë për rivendosjen e dinjitetit njerëzor.

14. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, trupi gjykues vëren se reputacioni dhe dinjiteti mbrohen kryesisht nën nenin 8 të Konventës, ndërsa neni 6 i saj garanton procedurën, jo rezultatin apo narrativën morale të vendimit, prandaj një shkelje procedurale e nenit 6, nuk mund të sjellë “korigjim të arsyetimit” me qëllim rehabilitimin moral. Në rastin konkret, pasojat procedurale janë adresuar përmes konstatimit të shkeljes nga GjEDNj-ja, të cilat nuk kërkojnë rihapje të vlerësimit material, si dhe nuk justifikojnë cenimin e një vendimi të formës së prerë të Kolegjit.
15. Në këtë kuadër, pretendimi për cenim të dinjitetit njerëzor, i lidhur me figurën e subjektit si gjyqtar, konsiderohet i korigjuar përmes efektit deklarativ të vetë vendimit të GjEDNj-së, i cili evidenton mangësi procedurale, pa mbajtur qëndrim mbi gjetjet materiale të organeve të rivlerësimit dhe pa vënë në diskutim vlerësimin e figurës në kuptim të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës. Procesi i rivlerësimit kalimtar, i parashikuar nga neni 179/b i Kushtetutës, përbën një mekanizëm kushtetues të jashtëzakonshëm, me objekt të përcaktuar qartë dhe me standarde të veçanta vlerësimi, të cilat nuk mund të anashkalohen përmes zgjerimit të efekteve të një vendimi deklarativ të GjEDNj-së.
16. Kërkuesi, më datë 03.03.2026, depozitoi në Kolegji, së bashku me parashtrimet shtesë, edhe vendimin<sup>12</sup> e Gjykatës së Lartë nr. 1826, datë 02.12.2025. Sipas kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nëpërmjet këtij vendimi, duke deklaruar pafajësinë e tij, “Për kryerjen e veprës penale ‘Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve’, të parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal”, ka arritur në përfundimin *inter alia*, se kërkuesi nuk ka qenë asnjëherë i dënuar me vendim fajësie të formës së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale. Sipas tij, kjo rrethanë lidhet drejtpërdrejt me dinjitetin dhe reputacionin, sepse korigjon çdo premisë që mund të ketë ushqyer një narrativë penalizuese dhe kriminalizuese në vlerësimin e figurës.

**16.1.** Trupi gjykues e vlerëson jorelevant pretendimin e kërkuesit, se ky vendim shërben për të mbajtur një qëndrim konfirmues për kriterin e kontrollit të figurës, për sa kohë që çështja penale e trajtuar në

---

*individuale rehabilituese. Gjykata nuk vuri në dyshim integritetin moral të gjyqtarës, por vetëm standardin procedural.* – <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-187507>

*Në çështjen “Denisov kundër Ukrainës” (GC, 2018) GjEDNj-ja bën dallimin midis cenimit të reputacionit si pasojë faktike dhe serioze, nga pakënaqësia subjektive e individit dhe thekson se jo çdo pasojë negative mbi figurën përbën shkelje që kërkon rehabilitim, duke konkluduar se vendimi deklarativ mjafton në mungesë të pasojave të vazhdueshme.* – <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-186216>

<sup>11</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 116, pika 1, germa b, si dhe neni 117, pika 3, në të cilën citohet se: “Marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen me ligj, shpallen dhe botohen sipas procedurave që parashikohen për ligjet. Shpallja dhe botimi i marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare bëhet sipas ligjit”.

<sup>12</sup> Gjykata e Lartë ka vendosur: “Mospranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, kundër vendimit nr. {\*\*\*}, datë 26.09.2022, të Gjykatës së Apelit Tiranë”, i cila ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 31.05.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe: Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Admir Thanza, akuzuar se ka kryer veprë penale të parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal”.

këtë vendim nuk ka qenë një element i vlerësuar në kuadër të kriterit të kontrollit të figurës, në vendimin objekt rishikimi.

17. Për sa analizuar më lart, trupi gjykues, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, arrin në konkluzionin se kërkesa për rishikimin e vendimit nr. 10, datë 18.04.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, mbështetur në vendimin e GjEDNj-së, nuk mund të shërbejë si një shkak për rishikimin e vendimit, në kuptim të nenit 494, germa “ë”, të Kodit të Procedurës Civile.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile,

**VENDOSI:**

Mospranimin e kërkesës së kërkesit Admir Thanza, për rishikimin e vendimit nr. 10/2019 (JR), datë 18.04.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

U shpall në Tiranë, më datë 10.03.2026.

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**KRYESUES**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*